

Mikrofinanca në Evropë: Raporti i Studimit 2020

Justyna Pytkowska

Përmbledhje ekzekutive

Ky studim paraqet një panoramë të sektorit të mikrofinancës gjatë periudhës 2018-2019, përpara fillimit të pandemisë së Covid-19. Megjithatë, duke qenë se të dhënat u mblodhën gjatë verës së vitit 2020, ky raport po publikohet pas pandemisë. Kjo bën që rezultati të jetë i veçantë, pasi raporti mund të konsiderohet se përmban të dhënat më të fundit të disponueshme mbi sektorin mikrofinanciar Evropian përpara se ai të goditej nga pandemia. Megjithatë, për këtë arsye, ky raport përfshin gjithashtu një kapitull mbi ndikimin fillestar të pandemisë në vitin 2020.

Ky është botimi i 9-të i këtij studimi për Rrjetin Evropian të Mikrofinancave (EMN) dhe për herë të tretë realizohet në bashkëpunim me Qendrën për Mikrofinancën (MFC). Bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy rrjeteve bën që ky studim të mbulojë pjesën dërrmuese të sektorit evropian të mikrofinancës, duke siguruar bazën më të plotë të dhënave të disponueshme aktualisht.

Studimi përfshin 143 institucione nga 29 vende dhe mbledh të dhëna për periudhën kohore 2018-2019.

Gjetjet kryesore

Për sa u përket **karakteristikave institucionale**, ky sektor përbëhet kryesisht nga institucione mikrofinanciare (IMF) jobanka (91%) që operojnë në treg në forma ligjore të ndryshme. Evropa Perëndimore ka më shumë banka ofruese të mikrokredivë, ndërsa Evropa Lindore ka më shumë unione krediti. Ofruesit e mikrokredivë punësojnë afërsisht 11 000 punonjës në mënyrë të drejtpërdrejtë, nga të cilët 22% janë vullnetarë që hasen më shpesh pranë OJQ-ve dhe bankave të Evropës Perëndimore. Ka një asimetri gjinore të dukshme, ku 65% e stafit të punësuar me pagesë janë femra, veçanërisht në kooperativa dhe në unionet e kreditit. Karakteristikat institucionale kanë mbetur kryesisht të qëndrueshme dhe rezultatet nuk kanë devijuar shumë nga studimi i mëparshëm, gjë që pritej.

Pjesa më e madhe e IMF-ve (63%) ofrojnë **shërbime jofinanciare**, veçanërisht në Evropën Perëndimore. Institucionet që ofrojnë kredi për individë shpesh prirën të ofrojnë shërbime të zhvillimit të klientit, si për shembull edukim financiar. IMF-të që nuk ofrojnë kredi për individë prirën të ofrojnë shërbime për zhvillimin e biznesit (p.sh. mentorim, konsulencë). Vetëm 28% e IMF-ve përdorin kanalet dixhitale për ofrimin e shërbimeve jofinanciare dhe këto janë më së shumti IMF-të e mëdha. Në përgjithësi, kjo pjesë e studimit konfirmon rëndësinë e shërbimeve jofinanciare dhe kalimin drejt ofrimit të këtyre shërbimeve në mënyrë dixhitale (të paktën të një pjese të tyre).

Si portofoli i mikrokredivë ashtu dhe numri i huamarrësve aktivë

shfaqën një trend rritës, çka rezultoi në një **rritje të konsiderueshme të këtij sektori**, në linjë me rezultatet e studimit të fundit. Në vitin 2019, numri total i huamarrësve ishte 1,26 milionë (+14% krahasuar me vitin 2018), me një portofol bruto të mikrokredivë të papaguara në vlerën 3,7 miliardë euro (+15%). Një përqindje e madhe e këtij portofoli është në duart e një numri të vogël ofruesish. Kreditë e biznesit përbëjnë 55% të totalit të portofolit të mikrokredivë, ndërsa kreditë për individë përbëjnë 45% të portofolit. Segmenti i kredivë për individë ka pësuar rritje më të madhe (23%) sesa segmenti i kredivë të biznesit (12%). Kjo rritje ndjek të njëjtën tendencë të vërejtur gjatë viteve të mëparshme, shoqëruar me rritje dhe maturim të tregut nga viti në vit. Vlen të theksohet rritja e vazhdueshme e kredivë për individë, duke qenë se ato përdoren kryesisht për nevoja familjare dhe vetëm 13% e tyre përdoren për zhvillim profesional. Kjo është një dukuri e spikatur veçanërisht për shkak të mungesës së një kuadri rregullator për këto nevoja në rritje.

Karakteristikat e kredivë kanë qenë gjithashtu relativisht të qëndrueshme krahasuar me vitet e tjera. Mikroreditë për biznes janë mesatarisht më të larta, me afat maturimi më të gjatë dhe normë vjetore të interesit (NVI) më të ulët krahasuar me kreditë për individë. NVI-të variojnë ndjeshëm sipas llojit të institucionit dhe rajonit. Institucionet financiare jobanka dhe IMF-të në Evropën Lindore kanë normat më të larta të interesit.

Për sa u përket **objektivave sociale**, përfshirja financiare mbetet

objektivi kryesor i veprimtarisë së IMF-ve, duke paraqitur një vizion të qëndrueshëm për këtë sektor. Gratë dhe popullsia e zonave rurale janë dy grupet kryesore të synuara. Një e treta e këtyre institucioneve u japin gjithashtu prioritet minoriteteve etnike/emigrantëve/refugjatëve.

Performanca financiare e shumicës së këtyre institucioneve mbetet e shëndoshë: 76% e institucioneve janë të pavarura nga ana operationale. Në këtë studim është kryer matja e tendencave përmes variablave të ndryshëm financiarë, të cilët shtjellohen më tej në raport.

Për sa i përket **financimit**, fondet e huazuara në terma afatgjatë mbeten burimi kryesor i financimit të portofolit të kredive. Vlera totale e financimit të nevojshëm është 800 milionë euro, me një vlerë mesatare prej 7,6 milionë euro. Nevoja totale për financim është më e lartë në Evropën Lindore (482 milionë euro) se sa në Perëndim (356 milionë euro). Në të dy rajonet, kërkesa më e madhe është

për financimin e borxhit. Për më tepër, IMF-të perëndimore kërkojnë më shumë grante/subvencione dhe garanci sesa IMF-të në lindje. Sfidat më të mëdha për sa i përket aksesit në fondet e nevojshme janë mungesa e fondeve (41% e IMF-ve), mungesa e garancive për të mbuluar riskun (38% e IMF-ve) dhe kostoja e financimit (37% e IMF-ve). Katër të pestat e institucioneve nuk përballeshin me ndonjë sfidë për sa i përket aksesit në financim.

Lidhur me **tendencat më të fundit**, ne konstatuam se shumë IMF kishin futur në përdorim teknologjitë e gjelbra, ku 16% e tyre ofronin produkte kredie të dedikuara për efikasitetin e energjisë. Gjithashtu, 23% e institucioneve planifikojnë të ofrojnë më shumë produkte të tilla në të ardhmen. Pjesa më e madhe e ofruesve kanë zgjidhje dixhitale për të mbështetur klientët gjatë kohëzgjatjes së kredisë, ndërsa një përqindje më e ulët e IMF-ve disponojnë mjete dixhitale më pak të sofistikuar. Rreth gjysma e të anketuarve planifikojnë të ofrojnë zgjidhje dixhitale në tri vitet e ardhshme.

Gjetjet kryesore në perspektivë

Në tërësi, rezultatet reflektojnë një rritje të qëndrueshme të sektorit mikrofinanciar gjatë dy viteve të fundit. Rritja totale mbetet e lartë për sa i përket madhësisë së portofolit dhe klientëve të rinj, ndërkohë që misioni social i këtij sektori dhe karakteristikat organizative mbeten përgjithësisht të pandryshuara. Vihen re disa dallime midis Evropës Perëndimore dhe asaj Lindore, por në përgjithësi ka më shumë ngjashmëri se sa dallime.

Nëse krahasojmë ofertën e mikrokredive në vitin 2019 (3,7 miliardë euro) me hendekun vjetor të vlerësuar të financimit, në shumën 12,9 miliardë euro, sipas propozimit të bërë nga analiza e tregut e Komisionit Evropian e botuar në Maj 2020¹ (bazuar në kërkesën e papërmbyshur), **mund të arrijmë në përfundimin se ky sektor ka ende hapësirë për rritje të ndjeshme përpara se të arrijë t'i shërbejë plotësisht tregut.**

Ndikimi i pritshëm i pandemisë së covid-19

Siç e përmendëm më sipër, është e pamundur të shohim një panoramë të vitit 2018-2019 pa pranuar se e ardhmja e afërt e këtij sektori do të ndikohet në mënyrë drastike nga Covid-19. Gjatë mbledhjes së të dhënave për këtë raport, realizuam një sërë intervistash me IMF-të, me qëllim inventarizimin dhe përcaktimin e fushave më të prekura nga kriza.

Pavarësisht pandemisë, pjesa më e madhe e IMF-ve e perceptojnë situatën si të mirë. Pothuajse 70% e IMF-ve e konsideronin veten në situatë të mirë, ndërsa vetëm 6% e tyre e gjykonin si të vështirë situatën e tyre aktuale. Sfidat kryesore me të cilat ndeshen IMF-të lidhen me paqëndrueshmërinë e të ardhurave të klientëve, si dhe me aftësitë e ulëta dixhitale dhe financiare të tyre. Sfidat e jashtme ishin më pak të ndjeshme, ku shqetësimet më të shpeshta lidheshin me aksesin në financim dhe ndërhyrjet politike.

IMF-të janë optimiste për të ardhmen: më shumë se gjysma e institucioneve mendojnë se perspektivat e biznesit do të përmirësohen në 12 muajt e ardhshëm. Ndikimi i mbylljes në muajt mars-prill 2020 ishte fillimisht i madh, për shkak të natyrës së saj të papritur dhe rreptësisë së kufizimeve, por me kalimin e kohës shumica e institucioneve gjetën mënyra për të garantuar mbijetesën e biznesit dhe vazhdimësinë e operationeve. IMF-të që operojnë në një mjedis me mbështetje të madhe nga qeveria ndaj bizneseve mikro dhe të vogla, e ndjenë më pak ndikimin e pandemisë, po ashtu dhe IMF-të që kanë partnerë të fuqishëm dhe aksionarë mbështetës.

Institucionet që kishin realizuar transformimin dixhital e kishin më të thjeshtë të përshtateshin me kërkesat e sigurisë dhe ishin më të përgatitura për të përdorur mjete dixhitale për të komunikuar me klientët, për të përpunuar kreditë dhe për të zbatuar proceset e punës në distancë.

¹ Mikrofinanca në Bashkimin Evropian: Analizë e tregut dhe rekomandime për mundësitë e ofrimit në periudhën 2021-2027

With contribution
by EIF



European
Commission



EUROPEAN
MICROFINANCE
NETWORK



MICROFINANCE CENTRE

This publication has received financial support from the European Union Programme for Employment and Social Innovation "EaSI" (2014-2020). For further information please consult: <http://ec.europa.eu/social/easi>

The information contained in this publication does not necessarily reflect the official position of the European Commission and European Investment Fund.